




**Republika e Kosovës**  
*Republika Kosovo - Republic of Kosovo*  
**Autoriteti i Konkurrencës**  
*Autoritet za Konkurenčiju - Competition Authority*



Nr. 31/2023

Prishtinë, më 17.03.2023

Mbështetur në nenin 11 paragrafi 1, 2 dhe 3 me nën paragrafët 3.1 dhe 3.2, neni 13 paragrafi 1 me nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 paragrafin 2, 3, 4, 5, 6, neni 20 paragrafi 1 me nën paragrafin 1.2, neni 26 paragrafi 1.2, neni 27 paragrafi 2, neni 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, neni 37, neni 38, neni 39 si dhe neni 55, paragrafi 2 me nën paragrafin 2.1 i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës; Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës duke vepruar sipas detyrës zyrtare, ka kryer shqyrtimin paraprak, lidhur me dyshimin e arsyeshëm se ndërmarrja Balfin Group ka realizuar shitblerje të aksioneve duke fituar kontrollin mbi ndërmarrjen NKL Limited, pa parashtruar kërkesën për lejimin e përqendrimit për të cilat përbushet detyrimi ligjor për njoftimin e përqendrimit. Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës, në mbledhjen e mbajtur, më datë 17.03.2023, nxjerr:

## KONKLUSION

për fillimin e procedurës hetimore ndaj:

- I. Ndërmarrjes **Balfin Group (Balkan Finance Investment Group)** - Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, me numër unik identifikues: K72223031K me adresë: Papa Gjon Pali II, Tiranë, Republika e Shqipërisë, për shkak të dyshimeve të arsyeshme se, e njëjta ka realizuar shitblerje të aksioneve mbi ndërmarrjen NKL Limited, pa u parashtruar kërkesa për lejimin e përqendrimit.
  - II. Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, kërkon nga ndërmarrja e lartcekur si në dispozitivin I të këtij Konkluzioni, këto dokumente:
    - Pasqyrat financiare të ndërmarrjes Balfin Group sh.p.k, për vitin 2017- 2018.
    - Marrëveshjen e transaksionit ndërmjet palëve.
  - III. Në rast se, pala në procedurë nuk i dorëzon komentet dhe dokumentet e kërkua si në dispozitivin II të këtij konkluzioni apo dorëzojnë dokumente të pa-sakta apo të rrëme, Autoriteti do të konstatojë shkeljen e këtij ligji dhe do t'u shqiptojë palëve sanksionin administrativ deri në 1% të qarkullimit vjetor të vitit paraprak dhe pastaj do të vazhdojë procedurën hetimore duke i përdorur mjetet tjera ligjore të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.
  - IV. Ky konkluzion hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, nga ana e Komisionit.

Autoriteti i Konkurrencës  
Rr. "Migjeni" nr. 21, ish objekti i "Bankës së Lubjanës" kati i VI-të, Prishtinë  
+381 /0/ 38 200 10982, info.konkurrenca@rks-gov.net

## A r s y e t i m

---

Autoriteti i Konkurrencës, ka filluar monitorimin e tregut duke u bazuar në shkrimet e botuara në mediat elektronike, rrjete sociale dhe burime tjera zyrtare, lidhur me dyshimin se ndërmarrja Balfin Group sh.p.k ka realizuar shitblerje të aksioneve mbi ndërmarrjen NKL Limited. NKL Limited ushtron kontrollin e drejtpërdrejtë mbi ndërmarrjen NewCo Ferronikel L.L.C, dhe filialin e saj, në tregun përkatës të Republikës së Kosovës. NewCo Ferronikel Complex LLC, ushtron aktivitete në fushën e metaleve të minierave dhe industrisë përpunuese në tregun gjeografik të Republikës së Kosovës.

Autoriteti me Vendim të datës 22.06.2018, me Nr. Prot. 51/18, ka lejuar Përqendrimin e ndërmarrjeve, për shitblerjen e 100% të aksioneve nga NKL Limited (blerës), Cunico Resources (shitës), **mbi** NewCo Ferronikel Complex LLC, (targeti), ku sipas marrëveshjes për shitblerje në mes të palëve, NKL Limited ishte kompani e zotëruar tërësisht nga katër (4) aksionarë të jashtëm, ndërsa Balfin Group nuk paraqitej si njëri ndër aksionarët e NKL Limited,

Andaj, Autoriteti pas mbledhjes së informatave lidhur me dyshimet për transaksionin e realizuar, rrjedhimisht blerjes së aksioneve dhe fitimit të kontrollit mbi ndërmarrjen në tregun përkatës, për të cilat dyshohet se përbushin detyrimin për paraqitje të Njoftimit për Përqendrim, sipas nenit 11 dhe 13 të Ligjit 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, ka autorizuar grupin dhe bartësin e rastit, me ç'rast Autoriteti ka filluar procedurën sipas detyrës zyrtare (ex-officio) në zbatim të nenit 36 paragrafi 3 dhe nën paragrafi 3.1.

### Palë në procedurë:

Palë, në këtë procedurë të zhvilluar nga Autoriteti konsiderohet, ndërmarrja:

1. Balfin Group sh.p.k (Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar).

### Përshkimi i gjendjes faktike:

Autoriteti, gjatë shqyrtimit paraprak, në tregun përkatës të Republikës së Kosovës, në bazë të informatave që posedon, ekziston dyshimi i arsyeshëm se: Balfin Group shpk., ka realizuar blerjen e aksioneve mbi ndërmarrjen NKL Limited, e që kjo ndërmarrje ushtron kontrollin e vetëm dhe të drejtpërdrejtë mbi ndërmarrjen NewCo Ferronikel, e cila vepron në tregun përkatës me aktivitetin në fushën e metaleve të minierave dhe industrisë përpunuese në tregun e Republikës së Kosovës.

Balfin Group shpk, eshtë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me Nr. të biznesit K72223031K, me seli në Rr. Papa Gjon Pali II, Godina nr.12, kati 11, nr.1206, Tiranë, Shqipëri.

Autoriteti konsideron se, transaksi/blerja është realizuar, pa e dorëzuar njoftimin e detyrueshëm për qëllimin e përqendrimit parashikuar sipas nenit 13 dhe 15 të Ligjit 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Bazuar në nenin 13 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, parashihet së pjesëmarrësit në përqendrim, duhet t'i kërkojnë paraprakisht Autoritetit t'ua lejojë realizimin e përqendrimit të synuar nëse:

1.1. pjesëmarrësit në përqendrim kanë mbi njëzet (20) milionë euro qarkullim të përbashkët në tregun ndërkontrollor dhe njëri pjesëmarrës në përqendrim ka mbi një (1) milion euro qarkullim në tregun e brendshëm.

Qarkullimi i pjesëmarrësve në përqendrim llogaritet sipas raporteve financiare të vitit finanziar që i paraprin vitit të përqendrimit. Nëse parashtruesit nuk kanë arritur të mbyllin raportet financiare vjetore para se të parashtronë kërkesën për lejimin e përqendrimit, qarkullimi i pjesëmarrësve llogaritet sipas raporteve financiare të vitit të fundit finanziar për të cilin janë mbyllur raportet financiare.

Autoriteti konsideron se çdo realizim i përqendrimit të ndërmarrjeve nga neni 13 i këtij ligji, pjesëmarrësit e përqendrimit janë të detyruar ta njoftojnë Autoritetin, kur të plotësohen kushtet e përcaktuara, gjithashtu Neni 12 e përcakton shprehimisht se ndalohen përqendrimet, që mund të shtrembërojnë ndjeshëm konkurrencën efektive, veçanërisht nëse përqendrimi i tillë ka si pasojë krijimin ose forcimin e pozitës dominuese, që nënkupton se lëndët e caktuara duhet t'i nënshtrohen paraprakisht vlerësimit, nga Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës.

Me rastin e vlerësimit për arsyeshmërinë e marrjes së vendimit, Autoriteti merr parasysh të gjitha rrethanat e rastit, veçanërisht peshën e dëmit që mund t'u paraqiten pjesëmarrësve të përqendrimit ose palëve të treta, si dhe efekteve të konkurrencës, që mund të lindin nga zbatimi i përqendrimit.

Andaj, nga sa më lartë, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 37 të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, vendosi si në dispozitiv të këtij Konkluzioni.

## AUTORITETI I KONKURRENCËS

### KOMISIONI

Neime Binaku + Isufi

Kryetar

Kaltrina Sela  
Zv. Kryetare



Nafije Osdautaj  
Anëtare

**Këshilla juridike:** Kundër, Konkluzioni për Fillimin e Procedurës Hetimore, nuk është e lejuar ankesa, as padia për inicimin e konfliktit administrativ.

Me këtë Konkluzion, të njoftohen:

- Pala në procedurë
- Arkiva

Autoriteti i Konkurrencës

Rr. "Migjeni" nr. 21, ish objekti i "Bankës së Lubjanës" katër i VI-të, Prishtinë  
+381 /0/ 38 200 10982, info.konkurenca@rks-gov.net